



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

# AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL POSTA AJRORE

Buletini Mujor I Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar


## AEROPORTI I VLORËS

### Mbyllet gara për aeroportin e Vlorës.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka mbyllur garën për Aeroportin e Vlorës. Ministria Belinda Balluku tha se kanë mbërritur dy oferta për ndërtimin dhe operimin e këtij aeroporti ndërsa shtoi se fillimi i Prillit do të shënojë edhe nisjen e punimeve për këtë investim strategjik që pritet të ketë një impakt të konsiderueshëm në ekonominë e vendit.

“Është mbyllur gara dhe ne kemi identifikuar dy oferta”, tha Ministria Balluku. Pritet që në mes ose në fund të muajit Mars, kontrata konçesionare të jetë nënshkruar dhe kështu në fillim të muajit Prill presim që të nisë puna në kantierin e aeroportit të Vlorës. Për shkak të pandemisë gara ka pasur disa vonesa të kuptueshme.

Pas aeroportit ndërkombëtar të Rinasit dhe hapjes së atij të Kukësit në fillim të pranverës së këtij viti siç është premtuar nga qeveria, aeroporti i Vlorës bëhet aeroporti i tretë në vend që mund të nisë operimin. ■



### Qantas, Qatar Airways dhe BA në mesin e kompanive ajrore më të sigurta për udhëtim në 2021

Airline Ratings, faqja kryesore në internet për vlerësimin e sigorisë së linjave ajrore, ka publikuar 20 linjat ajrore më të sigurta si dhe linjat ajrore kryesore që plotësojnë sukseshëm kërkesat pandemike të Covid për 2021.

Kompania ajrore Australiane Qantas është kompania ajrore më e sigurtë për udhëtim në 2021, sipas faqes profesionale të njohur të internetit **AirlineRatings**.

Është viti i tretë radhazi që Qantas e fiton këtë titull.

Në publikim e saj vjetor, AirlineRatings publikoi një renditje të 20 kompanive ajrore më të sigurta që operojnë në përputhje me kërkesat e pandemisë COVID-19 për këtë vit ndërmjet 385 kompanive ajrore të monitoruara.

E dyta në listën e linjave ajrore më të sigurta u rendit Qatar Airways, e ndjekur nga Air New Zealand në të tretën. Singapore Airlines u rendit e katërta, ndërsa Emirates doli e pesta.

Duke vazhduar renditjen e 10 të parave me EVA Air (6-ta), Etihad Airways (7-ta), Alaska Airlines (8-ta), Cathay Pacific Airways (9-ta), dhe **British Airways** (10-ta).



Redaktorët e faqes së internetit së bashku me këshilltarët e saj të industrisë morën parasysh një numër faktorësh për të bërë renditjet e sigorisë dhe produkteve.

Këto përfshinin element të tillë, siç janë: auditimet nga organet shtetërore të aviacionit dhe shoqatat profesionale; auditimet qeveritare; aksidentet e linjës ajrore dhe rekordin e incidenteve serioze, moshën e flotës, pozicionin financiar, trajnimin dhe kulturën e pilotëve.

Redaktorët e AirlineRatings.com shqyrtuan vetëm incidentet serioze për të marrë vendimin pasi siç thonë ata, "të gjitha linjat ajrore kanë incidente çdo ditë dhe shumë prej tyre janë çështje të prodhimit të avionëve ose të motorëve në vend të problemeve të operimit".

Linjat ajrore u vlerësuan gjithashtu për protokollin e tyre Covid-19 përmes një numri faktorësh, përfshirë informacionin në faqen e linjave ajrore për koronavirusin, furnizimin me maska të fytyrës për pasagjerët dhe PPE për ekuipazhin, ndryshimin e shërbimeve të ushqimit, pastrimin e thellë të avionit, furnizimin me pajisje personale për pastrim dhe distancimin shoqëror në bord. ■



Përshtati në shqip: B. Hazizaj

## BOEING 737 MAX

### Pas më shumë se dy vjetësh qëndrimi në tokë, avioni Boeing 737 MAX do të miratohet për të rifilluar fluturimet tregtare në Evropë.

Por rregullatori Evropian EASA tërheq vëmendjen se: avioni i tipit Boeing 737 MAX do të jetë subjekt i shqyrtimit nga afër.

“Javën që vjen çështja e avionit do qartësohet përsëri”, u tha dje gazetarëve gjatë nje eventit online ,Zoti Patrick Ky, drejtor ekzekutiv i EASA (Agjencia Evropiane e Sigurisë në Operim), duke shtuar se “avionët do të lejohen të fluturojnë për sa kohë që plotësohen kushtet e specifikuar nga agjencia dhe pilotët janë përditësuar në trajnimin e tyre.”

Avioni Boeing 737 MAX u ndalua nga EASA më 12 mars 2019, pas dy aksidenteve që rezultuan fatale, me rrëzimin e tyre dhe 346 jetë të humbura. Puna këmbëngulëse, e përkushtuar e rreth 20 ekspertëve të EASA-s për një periudhë 20 mujore i dha EASA-s besimin për të deklaruar se avioni do jetë i sigurtë për të fluturuar përsëri. Administrata Federale e Aviacionit e SHBA (FAA) publikoi miratimin e saj për modifikim e tipit 737 MAX në Regjistrin Federal më 20 nëntor 2020. ■


#### ***Për më shumë:***

<https://www.aviation24.be/organisations/easa-european-aviation-safety-agency/european-regulator-easa-approves-boeing-737-max-to-resume-flights-as-from-next-week/>



## VEPRIMTARIA RREGULLATORE

Në vijim të miratimit të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë (ligj nr.96/2020) dhe VKM Nr. 1095, datë 24.1.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", një tjetër akt nënligjor ka hyrë në fuqi, pas botimit të Fletoren Zyrtare Nr.19, datë 05.02.2021 dhe pikërisht Urdhëri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.26, datë 18.01.2021, që miraton rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre":



<http://qbz.gov.al/eli/urdher/2021/01/18/26>.

*Në këtë Rregullore janë përcaktuar kërkesat e përbashkëta për:*

- ◆ Ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror ('ATM/ANS') dhe funksioneve të tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror ('funksionet e rrjetit ATM') për trafikun ajror të përgjithshëm, veçanërisht për personat juridikë ose fizikë që ofrojnë këto shërbime dhe funksione; si dhe
- ◆ Autoritetet kompetente, dhe subjektet e kualifikuara që veprojnë në emër të tyre, të cilat ushtrojnë detyrat e certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit në lidhje me ofruesit e shërbimeve dhe funksioneve të përmendura në pikën (1).

Ky urdhër përaftron plotësisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr.2017/373, datë 1 mars 2017, mbi përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre.

Duke sjell gjithashtu shfuqizimin e dy akteve të tjera të mëparëshme nënligjore, siç janë urdhërat nr. 115, datë 23.10.2012 dhe nr.118, datë 23.10.2012, kjo rregullore do të kërkojë vazhdimin e punës së mëtejshme rregullatore nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil dhe ALBCONTROL SHA., shoqëria që menaxhon dhe kontrollon hapësirën ajrore Shqiptare (FIR), në përputhje me standardet ndërkombëtare të lundrimit ajror. ■

### Kompanitë ajrore për Evropën: Certifikatat e Vaksinës mund të ofrojnë një mjet për mbështetjen e rifillimit të udhëtimit në rrugë ajrore

Shoqata e Kompanive Ajrore për Evropën (A4E), beson se shanset që sigurojnë certifikatat e vaksinave duhet të konsiderohen nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian si një mënyrë për të koordinuar një qasje të përbashkët për të rivendosur udhëtimin ajror sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të sigurt.



Në një letër të hapur të botuar nga A4E, shoqata e linjave ajrore që numëron 16 anëtarë kryesorë dhe që përfaqëson mbi dy të tretat e trafikut ajror evropian, rekomandon disa qasje të thjeshta që Shtetet Anëtare të BE mund të ndërmarrin në mënyrë që të lehtësojnë udhëtimet në kushtet e pandemisë së COVID-19 dhe të ndihmohet udhëtimi ajror për të rimarr veten.

Para paraqitjes së rekomandimeve, shoqata njoftoi se "kompanitë Evropiane dhe sektori i gjerë i udhëtimeve nuk mund të pres derisa e gjithë popullsia të vaksinohet përpara se të bëjnë plane për të rifilluar operimet."

Sipas letrës së hapur, kryerja në vazhdimësi e programeve të vaksinimit dhe nivelet në rritje të mbrojtjes midis popullatës duhet të reflektohen në një heqje progresive të kufizimeve kombëtare të udhëtimit, në mënyrë që linjat ajrore dhe udhëtarët të kenë besimin e duhur për të planifikuar dhe rezervuar udhëtimet dhe pushimet e ardhshme për Pashkët dhe stinën e verës.

"Prandaj, ne u bëjmë thirrje Shteteve Anëtare që urgjentisht të bien dakord mbi një udhërrëfyes konkret për të rifilluar udhëtimin ajror. Një udhërrëfyes i tillë duhet të zhvillohet me industrinë përmes një task force të aviacionit dhe të turizmit ndërmjet institucioneve të BE dhe t'u paraqitet udhëtarëve evropianë si një rrugë e qartë për të udhëtuar," sugjeron shoqata.

Ajo gjithashtu vëren se Shtetet Anëtare duhet t'i përdorin sa më mirë fushatat e vaksinimit, të cilat mund të përdoren si një mjet shtesë për të mbështetur rifillimin e udhëtimit ajror, si dhe për të koordinuar më mirë rregullat mbi kufizimet e udhëtimit, testimin dhe karantinat.

Në të njëjtën kohë, shoqata bën thirrje për heqjen e ndalimeve totale të udhëtimit duke shtuar se kufizimet e udhëtimit dhe njoftimet nga vendi / rajoni i origjinës duhet të rregullohen në përputhje me situatën aktuale në zonën e destinacionit.

Ajo gjithashtu propozon që Shtetet Anëtare duhet të krijojnë korridore të sigurta udhëtimi me vendet e treta.

Për sa i përket testimit para / pas mbërritjes, shoqata rekomandon që antigjeni i besueshëm ose llojet e tjera të testeve të shpejta duhet të pranohen për hyrje në Shtetet Anëtare për shkak të kostos së tyre të ulët dhe kthimit shumë të shpejtë. ■

*Burimi:* <https://www.schengenvisainfo.com/news/airlines-for-europe-vaccination-certificates-could-provide-an-additional-tool-in-supporting-restart-of-air-travel/>

## Lufthansa njofton fluturimin më të gjatë për pasagjerë në historinë e saj të fluturimeve

Kompania më e madhe gjermane Lufthansa (LHAB) (LHA) planifikon të plotësojë një nga fluturimet e saj më unike që ajo ka kryer në historinë e saj.

Lufthansa (LHAB) (LHA) është e vendosur të ngrihet në fluturimin pa ndalesë për 15 orë, nga Hamburgu, Gjermani, në Ishujt Falkland. Bazuar në deklaratën e kompanisë, 92 pasagjerë, duke përfshirë dhe një

grup shkencëtarësh dhe ekipin e anijes nënujore kërkimore Polarstern, kanë rezervuar tashmë për këtë fluturim.

Ky fluturim i veçantë do nis më 1 shkurt 2021. ■



## NË KËTË NUMËR BULETINI MUJOR JANAR 2021

- Mbyllet gara për aeroportin e Vlorës.
- Qantas, Qatar Airways dhe BA në mesin e kompanive ajrore më të sigurta për udhëtim në 2021
- Pas më shumë se dy vjetësh qëndrimi në tokë, avioni Boeing 737 MAX do të miratohet për të rifilluar fluturimet tregtare në Evropë.
- Veprimtaria Rregullatore
- Kompanitë ajrore për Evropën: Certifikatat e Vaksinës mund të ofrojnë një mjet për mbështetjen e rifillimit të udhëtimit në rrugë ajrore
- Lufthansa njofton fluturimin më të gjatë për pasagjerë në historinë e saj të fluturimeve



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

### AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL



#### KONTAKT

ZYRA QËNDRORE

Rr. "Sulejman Delvina" P.O Box 205

Tiranë, Shqipëri

TEL: +355 4 225 12 20

WEB: [www.aac.gov.al](http://www.aac.gov.al)

EMAIL: [info@aca.gov.al](mailto:info@aca.gov.al)



### SEKTORI PËR TË DREJTAT E PASAGJERIT

TELEFON: +355 42 381 959

+355 44 539 959

EMAIL: [pax@aca.gov.al](mailto:pax@aca.gov.al)



#### REDAKTOI

**Z. Bujar Hazizaj** - Koordinator për të Drejtën për Informim

EMAIL: [Bujar.Hazizaj@aca.gov.al](mailto:Bujar.Hazizaj@aca.gov.al)

**Znj. Edlira Saliaj** - Këshilltare për Median

EMAIL: [Edlira.Saliaj@aca.gov.al](mailto:Edlira.Saliaj@aca.gov.al)



#### MEDIA SOCIALE

[facebook.com/AlbanianCAA](https://facebook.com/AlbanianCAA)

[autoriteti.aviacionit.civil](https://www.instagram.com/autoriteti.aviacionit.civil)